



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:098122

Datë: 16.11.2024

Numri i dokumentit: 06463257

C.nr.1602/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen kontestimore të paditësve B.K., A.A., I.R., S.Xh. dhe N.Sh. që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2,049.42 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 16.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve B.K., A.A., I.R., S.Xh. dhe N.Sh. që të gjithë nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditësve në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, t'ua kompensojë shumën dhe atë:

- Paditësit B.K.
 1. Për periudhën kohore 01.05.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 90.88 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro, apo shumën e përgjithshme prej 261.32 euro.
- Paditëses A.A.
 1. Për periudhën kohore 01.05.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 90.88 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 30.04.2021, në shumën prej 57.24 euro, apo shumën e përgjithshme prej 158.20 euro.
- Paditësit I.R.
 1. Për periudhën kohore 01.05.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 90.88 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro, apo shumën e përgjithshme prej 261.32 euro.
- Paditësit N.Sh.
 1. Për periudhën kohore 01.05.2019 - 31.12.2019, në shumën prej 52.16 euro.
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 5.76 euro.
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 98.52 euro, apo shumën e përgjithshme prej 156.44 euro.

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin paditës, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 17.05.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadiat e paditësit S.Xh. si dhe pjesërisht e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësve, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 2,049.42 euro, përkatësisht shuma prej 1,212.14 euro, konkretisht për paditësen B.K. shuma prej 290.38 euro, për paditësen A.A. shuma prej 363.53 euro, për paditësin I.R. shuma prej 256.72 euro, për paditësin S.Xh. shuma prej 140.28 euro, si dhe për paditësin N.Sh. shuma prej 161.23 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit B.K., A.A., I.R., S.Xh. dhe N.Sh. që të gjithë nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 17.05.2022, përmes të autorizuarit të tyre, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me të cilën kanë kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune në SHFMU “Nefit Jusufi” në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, paditëses B.K. i takon shuma në lartësi prej 551.70 euro, paditësit A.A. i takon shuma prej 521.73 euro, paditësit I.R. i takon shuma prej 518.04 euro, paditëses S.Xh. i takon shuma prej 140.28 euro, si dhe paditësit N.Sh. i takon shuma prej 317.67 euro. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 09.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padiat është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësve nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas

këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimet e lëshuara nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht nga vërtetimi me numër të referencës 20/2-2022 i datës 08.02.2022, për paditësen B.K. nga vërtetimi me numër të referencës 20/17-2022 i datës 08.02.2022 për paditësin A.A. nga vërtetimi me numër të referencës 20/5-2022 i datës 08.02.2022 për paditësin I.R. nga vërtetimi me numër të referencës 20/16-2022 i datës 08.02.2022, për paditësin S.Xh. si dhe nga vërtetimi me numër të referencës 20/7-2022 i datës 08.02.2022 për paditësin N.Sh. të lëshuara nga drejtori i shkollës, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune në SHFMU “Nefit Jusufi” në Prizren, si mësimdhënës, përveç paditësit N.Sh. si punëtor. Nga këto vërtetimi gjykata gjithashtu vërtetoi faktin se paditësi A.A. ka qenë në marrëdhënie punë pranë të paditurës deri me datë 30.04.2021, ndërsa paditësi S.Xh. deri me datë 23.05.2018.

Bazuar në Njoftimin e MASHT me numër protokolli 4540 të datës 11.12.2023, vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve e që është shuma prej 421.00 euro, ndërsa e paditësit N.Sh. është në shumën prej 241.68 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve iu takon e

drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.05.2019 - 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 90.88 euro ($421 * 2.7\% = 11.36 * 8 \text{ muaj} = 90.88 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.08 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.08 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.72 \text{ euro}$).

Ndërkaq sa i përket paditësit A.A.gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë deri me datë 30.04.2021, sepse me këtë datë ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të pensionimit, ashtu që kërkesa e tij rrjedh nga marrëdhënia e punës dhe derisa kjo marrëdhënie juridike ka përfunduar, atëherë përfundojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera që kanë lidhje me të njëjtin.

Ndërkaq sa i përket paditësit N.Sh. paga bazë e të cilit është 241.68 euro, llogaritja është bërë në këtë mënyrë,

- Për periudhën 01.05.2019 - 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 52.16 euro ($241.68 * 2.7\% = 6.52 * 8 \text{ muaj} = 52.16 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5.76 euro ($241.68 * 0.2\% = 0.48 * 12 \text{ muaj} = 5.76 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 98.52 euro ($241.68 * 3.4\% = 8.21 * 12 \text{ muaj} = 98.52 \text{ euro}$).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë

kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 17.05.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 17.05.2019.

Me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 17.05.2022, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.05.2019 e deri më 31.12.2021. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 17.05.2022, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin maj 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësve për muajin maj 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që të njëjtit kanë pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht të njëjtit pas pranimit të kësaj page janë njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin maj 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht qershor 2019, të njëjtit ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësit kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej 421.00 euro, duke u bazuar në Njoftimin e MASHT me numër protokollit 4540 të datës 11.12.2023, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve, e që është shuma prej 421.00 euro, ndërsa paditësi N.Sh. ka pagën bazë në lartësi prej 241.68 euro, dhe jo siç kanë kërkuar në petitum të padisë paditësja B.K. në shumën prej 551.12 euro, paditësi A.A. në shumën prej 521.21 euro, paditësi I.R. në shumën prej 571.43 euro, si dhe paditësi N.Sh. në shumën prej 317.67 euro, pasi që këto shuma përfshinë në vete edhe shtesat në pagë që i realizojnë paditësit. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 30.04.2019 si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësit dhe asaj që paditësit e realizojnë e që është në shumë prej 421.00 euro, pra shuma e tërësishme e parashkruar dhe pabazuar është në lartësi prej 1,212.14 euro, për paditësen B.K. shuma prej 290.38 euro, për paditësen A.A. shuma prej 363.53 euro, për paditësin I.R. shuma prej 256.72 euro, për paditësin S.Xh. shuma prej 140.28 euro, si dhe për paditësin N.Sh. shuma prej 161.23 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padisë në këtë gjykatë (17.05.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve tjera të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par. 2 të LPK-së, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale. Kështu, gjykata me rastin e vendosjes në mënyrë të tillë ka marrë parasysh suksesin e palës paditëse në procedurë, përkatësisht lartësinë

Numri i lëndës: 2022:098122

Datë: 16.11.2024

Numri i dokumentit: 06463257

e kërkesëpadisë së aprovuar në raport me lartësinë e kërkesëpadisë së kërkuar nga pala paditëse.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1602/2022, datë 16.11.2024

G j y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.